



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Raport për tremujorin e parë 2020

Oda e Mjekëve të Kosovës



Prill 2020

Prishtinë

Përmbajtja:

Raport për tremujorin e parë 2020.....	1
1. Këshilli Drejtues.....	3
2. Anëtarësimi	3
3. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	4
4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	6
5. Licensimet	6
6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	6
7. Këshilli Mbikqyrës	7
8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	7
9. Raporti financiar.....	7
9.1 Gjendja financiare – 31 mars 2020.....	7
9.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	8
9.3 Prokurimi	8
10. Aktivitete të tjera.....	8
10.1 Faksimilet me grada shkencore dhe thirrje akademike	8
10.2 Kongresi vjetor	9
10.3 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës	9
10.4 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	9
10.5 Marrëveshjet	10
10.6 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik	10
11. Plani i veprimit për 2020	10

1. Këshilli Drejtues

Në periudhën kohore janar–mars 2020, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime, ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas kërkesave/ ankesave së pranuar për periudhën TM1	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën TM1	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	5	1	4	<p>1- Vendim për kompensimin e ekspertëve;</p> <p>2- Vendim për aprovimin e rekomandimit të komisionit për inventarizim lidhur me asgjësimin e pasurisë së dëmtuar të OMK-së;</p> <p>3- Aprovimi i fillimit të procedurave të prokurimit për furnizim me material shpenzues zyrtar të OMK-së;</p> <p>4- Vendim për publikimin e njoftimit për rekrutim të nëpunësit për IT;</p> <p>5- Vendim lidhur me pagesën për aplikim për faksimil me tituj shkencor/akademik;</p> <p>6- Vendim për emërimin e anëtarëve të Redaksisë së Revistës së OMK-së;</p> <p>7- Vendim Autorizohet shërbimi Profesional i OMK-së që të bëjë negocimin me Hotel Everal për Kongres;</p>	3

2. Anëtarësimi

Gjatë periudhës janar-mars 2020, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 138 mjekë, ku 17 mjek janë të huaj dhe 121 mjekë vendas (duke përfshirë 11 mjekë të punësuar në sektorin publik, 13 mjekë të punësuar në sektorin privat, 97 mjekë të pa punë).




Tabela 1.1: Anëtarësime për periudhën janar-mars 2020




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri me datën 31 mars 2020

Gjatë periudhës janar-mars 2020 janë ç’anëtarësuar në mënyrë vullnetare dy mjekë, dhe janë rianëtarësuar 3 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 mars është 4383.

3. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM1	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM1	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	13	8	///	///	2	7
Këshilli Etik	10	28 (21 vendime dalin nga 4 lëndë)	Rekomandime kolegjale 21; Qortim Publik 2; Gjoha 4; Gjithsej : 4000.00€ Paushalli i procedurës: 25 1800.00€;	Qortim publik 1 (100.00€); Gjoha 0 (0.00€); Gjithsej: 100.00€ Shpenzime të paushallit : 5 250.00€	8	6
Gjyqi i Nderit	3	1	Sipas ankesës është anuluar vendimi i Këshillit Etik nr. KE. 67-2/2020	///	2	2
Certifikatat e të kaluarës etike	29	29	///	///	///	///

Në shqyrtim të drejtpërdrejtë, është mbajtur 1 seancë e shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në procedurën e mjetit juridik, pranë Gjyqit të Nderit, është ndryshuar një lëndë si rrjedhojë e paraqitjes së fakteve të reja të cilat nuk janë parashtruar pranë Këshillit Etik.

Vërejtje: Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është e pamundur që të nxirret bilanci i lëndëve në total, për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.


4. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të parë të 2020, ka akredituar 34 aktivitete.



5. Licensimet

Komisioni për Licensim dhe Rilicensim gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, ka lëshuar licensa me kategoritë si në grafikun më poshtë:



6. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

7. Këshilli Mbikëqyrës

Në periudhën kohore janar – mars 2020, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur dy (2) takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues - ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi, si dhe shqyrtimi i raportit të auditimit të jashtëm.

8. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Në periudhën kohore janar–mars 2020, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar katër (4) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka aprovuar të katër kërkesat e pranuar.

9. Raporti financiar

9.1 Gjendja financiare – 31 mars 2020

1.0 Të hyrat:		
1.0.1 Të hyrat e shtyra nga 2019	€304,543.00	
Të hyrat e shtyra nga 2019	€304,543.00	
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	TOTAL TM1
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€232,820.00	€232,820.00
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€5,250.00	€5,250.00
1.1.4 Licensimi	€9,420.00	€9,420.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€10,013.00	€10,013.00
Të hyrat nga TM	€257,503.00	€257,503.00
Të hyrat e shtyra nga 2019		€304,543.00
TOTAL TË HYRAT		€562,046.00

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	TOTAL TM1
2.1 Paga, mëditje dhe kontributet pensionale	€37,267.55	€37,267.55
2.3 Material shpenzues për zyrë	€1,490.26	€1,490.26
2.4 Reprerentacioni	€282.20	€282.20
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€4,699.00	€4,699.00
2.6 Shpenzimet e tjera*	€5,036.84	€5,036.84
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€6,600.00	€6,600.00
TOTAL SHPENZIMET TM:	€55,375.85	€55,375.85
TOTAL SHPENZIMET		€55,375.85
TOTAL BILANCI		€506,670.15

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitetet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera

2.6 *Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

9.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës ka dhënë përkrahje financiare për Edukim të Vazhdueshëm Profesional gjatë tremujorit të parë për:

- Kongresin e parë Ndërkombëtar të Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës në vlerë prej 2.000.00€.
- Shoqatën e Kirurgëve Torakal të Kosovës në organizimin e Workshop me VATS / Kirurgjia minimal invasive, në vlerë prej 2.000.00€.
- Qendrën e Mjekësisë Urgjente Prishtinë në organizimin e puntorisë për përpunimin dhe adaptimin e grupit të tretë të udhërrëfyesit të punës për përdorim të brëndëshëm, në vlerë prej 700.00€.

9.3 Prokurimi

Gjatë periudhës kohore janar-mars 2020, u zhvilluan dy procedura të hapura të prokurimit për: Furnizim me material shpenzues zyrat e OMK-së.

Në muajin janar u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për Furnizim me material shpenzues zyrat e OMK-së. Si rezultat i kësaj ftese u pranua ofertë nga dy operator ekonomik, dhe si rrjedhojë për shkak të mospërmbushjes së kushtit për zhvillim të procedurës së prokurimit, u bë anulimi i procedurës.

Ftesa për Tender për furnizim me material shpenzues për zyrat e OMK-së u rishpall me Vendim të Këshillit Drejtues në muajin shkurt, dhe kësaj radhe procedura e prokurimit u zhvillua me sukses.

10. Aktivitete të tjera

10.1 Faksimilet me grada shkencore dhe thirrje akademike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës, me datë 17 dhjetor 2019 ka mbajtur mbledhjen e rregullt ku janë shqyrtuar propozim amendamentet e akteve juridike të Odës. Në kuadër të këtij takimi u miratuan amendamentet për plotësim ndryshimin e akteve normative, ku ndër të tjera është amendamentuar Neni 24 i Rregullores për Regjistrimin, Licensimin dhe Rilicensimin e Mjekëve, i cili parasheh përmbajtjen e faksimilit. Në këtë rast Kuvendi ka aprovuar që në faksimil të shtohen edhe gradat shkencore dhe thirrjet akademike për ata që posedojnë atë. Si rezultat janë aprovuar 153 faksimila me grada shkencore dhe thirrje akademike përgjatë periudhës janar-mars 2020.

10.2 Kongresi vjetor

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2020 është Kongresi Mjekësor.

Këshilli Drejtues ka marrë vendim, që Kongresi vjetor i organizuar nga Oda, do të mbahet më 16 dhe 17 tetor 2020. Kongresi do të jetë i fokusuar në lëminë e Onkologjisë interdisciplinare.

Me 11 mars u zgjodh Këshilli Organizativ i përbërë nga 13 anëtarë, ku si përgjegjësi kryesore do të kenë organizimin dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit vjetor.

10.3 Revista mjekësore e Odës së Mjekëve të Kosovës

Me propozim të Këshillit Drejtues në mbledhjen e kuvendit të OMK-së u morr vendim për themelimin e Revistës shkencore të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Me datë 2 mars Këshilli Drejtues emëroi anëtarët e redaksisë së revistës, ku si rrjedhojë me datë 9 mars u mbajt takimi i parë i anëtarëve. Në takimin e parë u vendos që revista të jetë informative, e cila do të botohet dy herë në vit, për të cilën u propozua që numri i parë të botohet me datë 1 qershor.

10.4 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësive profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësive individuale të mjekëve të cilët u janë nënshtruar procedurave penale apo dhe civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Ekspertizat:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas urdhëresave së pranuar për periudhën TM1	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën TM1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Kryetari i Odës	0	0	2	1	3

10.5 Marrëveshjet

Me 16 janar 2020, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi në mes të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Kosova's Organization of Medical Students KOMS. Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i bashkëpunimit përmes të cilit palët shprehin interesim të punojnë së bashku për integrimin e studentëve dhe profesionistëve kosovarë të fushave të shëndetit dhe mirëqenies në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të ngritjes profesionale, zhvillimit të shkencave mjekësore dhe përmirimit të jetës sociale të qytetarëve.

10.6 Shpallja e Emergjencës së shëndetit publik

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 15 mars 2020, shpalli emergjencën për shëndetin publik, si dhe morri vendimin nr. 01/09. ku sipas këtij vendimi janë përcaktuar masat mbrojtëse për parandalimin dhe trajtimin e virusit pandemik COVID 19. Me qëllim të zbatimit të vendimit dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së OMK-së, që nga data 16 mars 2020, OMK-ja ka pezulluar punën me palë pranë selisë së saj, kështu që zyrat e selisë së OMK-së kanë qenë të mbyllura deri në zbatimin e masave të tilla të përkohshme. Të gjitha shërbimet e mundshme për anëtarët e OMK-së janë rekomanduar që të bëhen përmes ueb faqes zyrtare të OMK-së dhe postës zyrtare elektronike të OMK-së.

11. Plani i veprimit për 2020

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha OPSH-të, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK-ja drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit – 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i Revistës mjekësore.
- Organizimi i Kongresit vjetor i fokusuar në lëmin e Onkologjisë.